

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 784 Rep.
NR. 310 Kol.

A2020053840021583321



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI
PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, TË NDRYSHUAR**

Në Tiranë, më datë 09, muaji 06, viti 2020 (dymijë e njëzetë), para meje noter Beutanaq Shab, anëtar i dhomës së Noterisë 1/1404, me adresë qendra Beutanaq, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 4064 Prot, datë 29.05.2020 (kopje bashkëlidhur) nga Z. Ilir Tomorr Bejtja, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftimi ID

DHE

Shoqërisë Koncesionare **“VOKOPOLA ENERGJI” Sh.p.k.**, themeluar si person juridik më datë 22.01.2013 dhe rregjistruar në QKB datë 07.02.2013, me NUIS L31407010B, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Zj. Egresa Mavriqi, e datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga Kata ID, me Nr. Persona _____

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse të Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) me Nr. 7 Rep. & Nr. 3 Kol, për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “UFO” sh.p.k dhe “GERI 01” sh.p.k. (Koncesionari), hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 10 Janar 2013, të ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr. 110 Rep.& 31/3 Kol. “Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, lidhur ndërmjet Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritetit Kontraktues) dhe shoqërisë koncesionare “Vokopola Energji” sh.p.k. hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët, në datën 17 Janar 2019.

Hyrje

A2020053840021583321



Duke pasur parasysh:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “UFO” sh.p.k dhe “Geri 01” sh.p.k. (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Konçesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, me Nr. 7 Rep. & Nr. 3 Kol, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 10 Janar 2013 (në vijim referuar si “Kontrata e Konçesionit”);
- Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr. 110 Rep.& 31/3 Kol. “Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3” lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritetit Kontraktues) dhe shoqërisë koncesionare Vokopola Energji sh.p.k., hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 17 Janar 2019;
- Shkresën e Autoritetit Kontraktues me Nr. 8511 Prot. datë 02.10.2019, drejtuar shoqërisë koncesionare “Vokopola Energji” sh.p.k “*Njoftim për rregullimin e shkelleve me pasojë zgjidhjen e kontratës koncesionare*”;
- Shkresën e shoqërisë koncesionare “Vokopola Energji” sh.p.k., me Nr. 8511/1 Prot. datë 22.10.2019 “*Informacion mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në përgjigje të shkresës Nr. 8511 Prot datë 02.10.2019*”, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me anë të së cilës ka paraqitur pretendimet e saj mbi gjetjet për mospërmbushjen e detyrime kontraktuale, shoqëruar me dokumentacionin përkatës justifikues;
- Shkresën e Autoritetit Kontraktues me Nr. 8511/2 Prot. datë 16.01.2020 “*Kthim përgjigje*” drejtuar shoqërisë koncesionare “Vokopola Energji” sh.p.k, nëpërmjet të cilës i bën me dije se ka marrë parasysh pretendimet e shoqërisë të paraqitura nga ana e saj me dokumentacion justifikues dhe ka vlerësuar se shoqëria ka kryer veprimet e nevojshme administrative në përmbushje të detyrimeve kontraktuale dhe se është në kushtet e fillimit të negociimit dhe nënshkrimit të shtesës së kontratës të koncesionit për realizimin e objektit të kontratës koncesionare;

Si dhe duke u mbështetur në:

- Nenin 28 “Ndryshime”, të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se kjo kontratë mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve;
- Nenin 29 “Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit”, të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Konçesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, nënshkruar nga palët datë 10 Janar 2013, me

Nr. 7 Rep. & Nr. 3 Kol, të ndryshuar me kontrën shtesë Nr. 110 Rep. & Nr. 31/3 Kol “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit” të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “VOKOPOLA 1” & “VOKOPOLA 2” & “VOKOPOLA 3”, nënshkruar nga palët më datë 17 Janar 2019 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

A2020053840021583321



Neni 1

Në nenin 10 “Programi i Punimeve”

në pikën 2, shprehja: “..... Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit...”, zëvendësohet me shprehjen: “..... Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e kësaj kontrate shtesë koncesioni....”.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilat e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

SHOQËRIA KONCESIONARE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

“Vokopola Energji” sh.p.k

**Përfaqësuar me Autorizim
Nr.4064 Prot., datë 29/05/2020**

Përfaqësuar nga:

**të Ministrit të Infrastrukturës
dhe Energjisë nga:**



Z. Ilir BEJTJA

Zj. Egresa MAVRIQI



FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

Nr. 070330440029731-33

Nr. ref.

Data 12/05/2020

Per : **Ministria e Infrastruktures dhe Energjise**
Blvd Deshmoret e Kombit nr.1001, Tirane

Duke qene se:

- Shoqeria "Vokopola Energji" shpk me Nipt L31407010B, ka lidhur kontraten e Koncesionit te Formes "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3 , Nr 7 Rep. Nr 3 Kol, date 16 Janar 2012 me Ministrine e Energjise dhe Industrise sot Ministria e Infrastruktures dhe Energjise (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"); dhe
- Shoqeria ka paraqitur prane nesh Kontraten e Koncesionit te formes BOT Nr 7 Rep, Nr 3 Kol, date 16 Janar 2012 te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit; dhe
- ne kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- Shoqeria e Sigurimeve **EUROSIG sh.a** eshte dakord te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:


- jemi garantuesit e kontrates se siper permendur deri ne shumen totale **94,234,654 leke (nentedhjeteeekatermilion edyqindetridhjeteeekatermijeeqjashteqindepesedhjeteeekater) leke** shume e cila eshte e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate; dhe
- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej **94,234,654 leke**; dhe
- per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Koncesionarit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtese apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na eliron nga detyrimet e kesaj Garancie, por siguruesi duhet te njoftohet me shkrim.

Kjo Çertifikate Garancie eshte e vlefshme per nje periudhe **12 (dymbedhete)** mujore nga data e lidhjes se kesaj kontrate dhe e rinovueshme cdo vit kalendarik, deri ne 30 dite nga data e leshimit te Çertifikates se Perfundimit por nuk i kalon afatet ligjore te vendosura dhe te rena dakord midis paleve ne Kontraten e Koncesionit si dhe akteve ligjore ne zbatim te kontrates.

Leshuar ne Tirane, me 12/05/2020 dhe e vlefshme deri ne 11/05/2021, ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 8081, date 07.03.1996 ndryshuar me Ligjin Nr.9267, date 29.07.2004 "Mbi veprimtarine e Sigurimeve dhe Risigurimeve" dhe ne baze te Ligjit Nr. 7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise". Kjo garanci nuk i tejkalon afatet ligjore te percaktuara ne kontraten koncensionare apo akteve ligjore ne zbatim te kontrates.

SIGURUESI
EUROSIG sh.a

Xhevdet KOPANI
Drejtor i Pergjithshem



I SIGURUARI
"Vokopola Energji" sh.p.k

Administrator



KUSHTET E PERGJITHSHEME TE KONTRATES SE SIGURIMIT TE GARANCIVE TE KONTRATAVE

JREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

jo kontrate garancie e lidhur midis Garantuesit dhe Kontraktuesit, i siguron Perfituesit ne rast se Kontraktuesi nuk ploteson detyrimet e tij kundrejt perfituesit me plotesimin e detyrimeve ndaj perfituesit. Garantuesit (Eurosig Sh.a) i lind e drejta qe ti drejtohet kontraktuesit, me te gjitha mjetet ligjore, per te bere rimbursimin e shpenzimeve te kryera ne funksion te plotesimit te detyrimeve ndaj perfituesit (cedimi i te drejtave nga Perfituesi te Garantuesit) brenda 10 diteve nga njoftimi i bere kontraktuesit nga perfituesi. Ne rast se Kontraktuesi brenda afatit 10 ditor nuk paguan shumen e Garantuuar, Kontraktuesi pranon detyrimin per te paguar per cdo dite vonese, kamaten ne masen 1% te shumes se Garantuuar

3. Kontraktuesi eshte i detyruar dhe pergjegjesi kryesor per permbushjen e detyrimeve qe lindin nga kontrata, kundrejt perfituesit. Kontraktuesi me marrjen e dokumentit te pageses se kryer nga Siguruesi ne favor te Perfituesit, detyrohet te rimbursojë siguruesin siç është përcaktuar ne piken 2/te Kushteve të përgjithshme.
4. Gjate afatit të vlefshmerise së kesaj garancie të kesaj kontrate, per cdo pagesë te kryer nga kontraktuesi ne favor të perfituesit ne ekzekutimin të detyrimeve kontraktuale të kontraktuesit ndaj perfituesit, masa e cdo pagesë të kontraktuesit do te ulet automatikisht detyrimin e kontraktuesit ndaj perfituesit, e për pasojë do të ulet automatikisht edhe shumën e garantuar. Në keto kushte, shumën monetare që garantuesi do të paguaje ne favor te perfituesit, ne rast te mosplotesimit të detyrimeve kontraktore nga kontraktuesi, për periudhen e mbetur pas kryerjes se pageses nga kontraktuesi, do të ulet në masen e pagesës së bere nga kontraktuesit ne favor të perfituesit.
5. Garantuesi ofron shërbimin e garancisë ndaj kontraktuesit kundrejt pageses së primit siç përcaktohet në certifikatë, i cili është i pagueshem teresisht në momentin e lëshimit të certifikates së garancisë. Ne rastet kur pagesa e primit nuk eshte kryer ne afat zbatohen neni 1129, e vijues te Kodit Civil.
6. Mbulimi ne sigurim fillon pas pagimit teresisht se tarifës së sigurimit të përcaktuar si më lart. Në rast se do te bihet dakort që primi të paguhet me dy keste, atehere mbulimi në sigurim fillon pas pagimit të 60% të tarifës totale te sigurimit. Në rast se Kontraktuesi nuk paguan tarifën e sigurimit në afatin e përcaktuar në kete kontrate, atehere sigurimi i ofruar pezullohet deri në orën 24:00 te dites që Kontraktuesi paguan çmimin e garancisë që detyrohet të paguaje (primi i sigurimit), në rast se primi nuk paguhet nga kontraktuesi brenda afatit te 30 diteve, shoqëria Eurosig sh.a ka të drejtë të revokojë sigurimin e kontratës duke njoftuar palet kontraktuese me shkrim.
7. Me pezullim të sigurimit kuptojmë: Garantuesi nuk është pergjegjes ndaj Perfituesit për të paguar në favor të tij shumën monetare deri në kufirin e shumës së sigurimit (dhe as mbi atë kufi), për shkelje të detyrimeve kontraktore të Kontraktuesit ndaj Perfituesit bazuar ne kontratën lidhur midis Kontraktuesit dhe Perfituesit apo cdo akti tjetër ligjor apo nënligjor, deri ne evitim e kushteve (pagimin e çmimit të sigurimit) që çuan në këtë pezullim.

DISPOZITA TE PERGJITHSHEME

8. Garantuesi do të paguaje në favor te perfituesit kur jemi në kushtet e kontratës së garancisë së kontratës dhe certifikates perkatëse se garancisë, por jo më tepër se shumën e garantuuar e përcaktuar këtu më sipër si kufiri maksimal i pergjegjesisë së Garantuesit.
9. Kontraktuesi është i detyruar ti dorëzojë perfituesit këtë kontratë të garancisë së kontratës dhe certifikaten e garancisë se kontratës perkatëse, e cila është pjesë perberëse e kesaj kontrate.
10. Certifikata e garancisë së kontratës është vlefshme vetëm kur është e shoqëruar me kushtet e pergjithshme të sigurimit të garancisë mbi bazen e se cilës ajo është lëshuar, ne të kundërt Certifikata e Garancisë është e pavlefshme.
11. Në rast se perfituesi nuk e kundërshton kontratën e garancisë së kontratës dhe certifikaten perkatëse se garancisë brenda 15 diteve nga data e nënshkrimit te kontratës midis tij dhe Kontraktuesit (kontratë kjo objekti i kesaj kontrate garancie kontrate) atehere kjo kontrate garancie dhe certifikata e garancisë së kontratës e lëshuar në baze te saj do te konsiderohen te pranuar nga Perfituesi dhe nuk mund të kundërshtohen më.

Kushte paraprake per dhenien e demshperblimit per perfituesin do te konsiderohen:

Kontraktuesi, ka per detyrë të dorëzojë prane Garantuesit:

- a. Projekt zbatimin e kryerjes së shërbimeve të marra përsipër sipas kontratës se supermarrjes.
- b. Grafikon e detajuar ditore për realizimin e pikes 1.
- c. Per shërbimin e kryerjes së punimeve të ndërtimit Kontraktuesi përvec kërkesave me lart duhet: Cdo datë 5 të muajit pasardhes të paraqesë me shkrim ecurine e grafikut të punimeve sipas grafikut të planifikuar, Kontratën e sigurimit të punimeve gjatë ndërtimit, montimit, deri ne procesin e vënies ne pune.

Kusht për lëshimin e kesaj garancie është lidhja e Kontrates midis te Siguruarit dhe Perfituesit. Ne rast se kjo kontrate nuk ekziston ose shpallet e pavlefshme atehere edhe Shoqëria e Sigurimit nuk ka detyrim te paguaje shumen e sigurimit.

Eshte kusht paraprak per dhenien e demshperblimit qe Kontraktuesi te vendose ne favor te Garantuesit kolateral te rendit te pare nje pasuri te paluajshme, ne nje vlere prej 130% te vleres se garantuuar, e përcaktuar ne formularin e polices, ne nje afat kohor prej 30 ditesh nga data e lëshimit te Garancisë se Kontrates. Ne rast se Kontraktuesi nuk e ploteson nje kusht te tille, atehere Siguruesi cillohet nga cdo detyrim per te paguar demshperblim ndaj Kontraktuesit dhe/ose Perfituesit dhe Garancia e Kontrates do te konsiderohet e perfunduar.

12. Efekti veprues i kesaj kontrate garancie qe do te thote fillimi i detyrimit te Garantuesit sipas kesaj kontrate, fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar ne marrveshjet dhe / ose kontratat e lidhuara midis kontraktuesit dhe perfituesit qe sjellin detyrimet kontraktore per kontraktuesin, qe do te thote se perfituesi nuk mund të paraqese kërkesa në zbatim te kesaj kontrate kur Kontraktuesi është brenda afatit për permbushjen e detyrimeve të tij ndaj perfituesit sipas dispozitave ne fuqi.
13. Perfituesi (Autoriteti prokurues qe organizon procesin e tenderimit) ka të drejtë ti drejtohet Garantuesit për marrjen e demshperblimit deri në shumën e garantuuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotesohen per faj te kontraktuesit / ekzekutuesit të kontratës (pra kur nuk është faj i Perfituesit / Autoritetit). Me "faj të kontraktuesit" kuptohet dështimi i Kontraktuesit për të permbushur dhe realizuar detyrimet që rrjedhin prej kontratës së lidhur midis tij dhe perfituesit. Me "faj të Perfituesit" kuptohet dështimi i perfituesit (Autoritetit prokurues) për ta paguar kontraktuesin siç parashikohen në kontratë, ose dështimi i tij në permbushjen e detyrimeve të tjera që rrjedhin prej kontrates së ndërtimit / shërbimit.
14. Në rast se nuk është faj i perfituesit, detyrimi i Garantuesit do të lindë pasi Perfituesi ka njoftuar me shkrim Kontraktuesin dhe Garantuesin dhe ka mbajtur një takim me ta me procesverbal të rregullt jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit, takim i cili bëhet për te diskutuar mbi mënyrën e plotësimit të detyrimeve kontraktore. Në kushtet e lindjes se detyrimit të Garantuesit, ky i fundit mund të zgjedhë nje nga opsionet:
 - a) Garantuesi bën pagesen e demshperblimit ne favor te Perfituesit deri ne shumën e garantuuar dhe në këte rast Perfituesi vendos vete nëse kontratën do ta vazhdojë me te njejtin Kontraktues apo do të zgjedhë nje Kontraktues tjetër.
 - b) Garantuesi merr vetë përsipër përfundimin e detyrimeve kontraktore (në vlere deri në shumën e garantuuar) duke zgjidhur vetë një Kontraktues të kualifikuar.
15. Perfituesi duhet te paraqesë kërkesen për demshperblim (kërkesen për ekzekutimin e garancisë) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:
 - a) Certifikatën origjinale të garancisë ose fotokopjen e saj.
 - b) Fotokopjen e kontrates (së punimeve, shërbimeve etj.) së lidhur midis Perfituesit dhe Kontraktuesit
 - c) Fotokopjet e vendimit të gjykatës nëse ka te tille.
 - d) Prova qe vërteton humbje (mosplotesimin e detyrimeve nga Kontraktuesi)
16. Barra e shpenzimeve për sigurimin e provave ekspertizave etj. që vërtetojnë humbjen, mosplotesimin e detyrimeve të Kontraktuesit bien mbi Perfituesin Eshte kusht paraprak per dhenien e demshperblimit qe Kontraktuesi te vendose ne favor te Garantuesit kolateral te rendit te pare nje pasuri te paluajshme, ne nje vlere prej 130% te vleres se garantuuar, e përcaktuar ne formularin e polices, ne nje afat kohor prej 30 ditesh nga data e lëshimit te Garancisë se Kontrates. Ne rast se Kontraktuesi nuk e ploteson nje kusht te tille, atehere Siguruesi cillohet nga cdo detyrim per te paguar demshperblim ndaj Kontraktuesit dhe/ose Perfituesit dhe Garancia e Kontrates do te konsiderohet e perfunduar.
17. Per zgjidhjen e mosmarrveshjeve që mund të lindin midis kontraktuesit dhe perfituesit palët mund të:
 - a) Përcaktojnë një palë të tretë (inxhinier, arkitekt, ekspert kontabel) e cila do te lëshojë një deklaratë noteriale nëpërmjet se cilës vërtetohet përgjegjësia për shkeljen e detyrimeve kontraktore. Një kopje e kesaj deklarate do ti jepet Garantuesit
 - b) Nese mosmarrveshjet nuk zgjidhen me ndërmjetësimin e palës së tretë, atehere palët i drejtohen Gjykatës së Vendit ku ndodhen zyrat e Garantuesit per te përcaktuar fajin.
18. Kontrata e garancisë mund të zgjidhet me kërkesën e secilës palë nënshkruese, duke bërë njoftim paraprak me shkrim të paktën 5 (pesë) ditë përpara dhe me kusht që nuk ka filluar përdorimi i shumës së garantuuar. Me këtë rast Kontraktuesi detyrohet ti dorëzojë Garantuesit certifikaten e garancisë (faktin i cili dëshmon se perfituesi ka bërë në miratimin për anulimin e kontratës dhe certifikates së garancisë. Kur kontrata zgjidhet nga Kontraktuesi, Garantuesi mban shpenzimet e marrjes në sigurim në masen 20% të primit.

ENERGJI
KONTRAKTUESI

SUBSIDIAR E SIGURIMIT
GARANTUESI

L31407010B